



## **Periudha e Votimit Përmes Postës**

**Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njofton aplikuesit e regjistruar suksesshëm si votues jashtë Kosovës se periudha e votimit përmes postës ka filluar me 2 shkurt dhe përfundon me 12 shkurt 2021.**

### **Si plotësohet fletëvotimi?**

Në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ju mund të votoni vetëm për një Subjekt Politik të renditur në anën e majtë të fletëvotimit, ndërsa në anën e djathtë mund të votoni deri në pesë kandidatë nga ai subjekt politik.

Fletëvotimin dhe broshurën me emrat e kandidatëve për secilin subjekt politik mund t'i gjeni në linkun: <https://www.kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/votimi-me-poste/>

### **Si duhet ta dërgoni pakon me fletëvotim në adresë të KQZ-së?**

- Fletëvotimin e plotësuar vendosni në një zarf të pashënuar dhe mbylleni. Kjo do të ruajë fshehtësinë e votës suaj.
- Zarfin e pashënuar dhe kopjen e një dokumenti identifikues të vlefshëm vendoseni në zarfin e kthimit, në të cilin e shënoni adresën postare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

### **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Republika e Kosovës**

#### **Votimi Përmes Postës**

**Posta nr. 6, Kutia Postare 351**

**10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës.**

Fletëvotimin përmes postës, duhet ta dërgoni vetëm për vete apo rrethin e ngushtë familjar. Nëse dërgoni fletëvotime për persona të tjerë, fletëvotimet do të refuzohen!

**Fletëvotimi duhet të pranohet nga KQZ-ja më së largu deri më 12 shkurt 2021.**